



Nr.

.....
KONTRATE
SIGURIMI PER PENSIONE SUPLEMENTARE
ME INSTITUTIN AMERIKAN TE PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE
(ME INDIVIDET)

Mbeshtetur ne nenin 26 Ligjit nr.7943, date 1.06.1995 "Per pensionet suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve " (i ndryshuar) si dhe ne Rregulloren "Per Perfitimet Suplementare te te Siguruarve..." te Institutit Amerikan te Pensioneve Private Suplementare te Shqiperise

Sot, me date, lidhet kjo kontrate midis paleve te meposhtme:

- ❖ **INSTITUTIT AMERIKAN TE PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE**, sh.a i krijuar sipas legjislacionit shqiptar, i licensuar nga Inspektoriati i Instituteve Private te Pensioneve Suplementare me lejen nr.2, date 7.07.2005, regjistruar ne Regjistrin Tregetar me vendimin nr. 33825, date 18.07.2005, te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, me seli ne adresen Rr. Dervish Hima, 11/k, Tirane Shqiperi, (me poshte i quajtur "SIGURUESI"), i perfaqesuar nga Z. Arian Kraja, Drejtor i Pergjithshem

Dhe

- ❖ **Z.....**, shtetas shqiptar, lindur ne....., me, mbajtes i pasaportes(bashkelidhur fotokopje e pasaportes), banues ne adresen: (me poshte i quajtur "I SIGURUARI").

Neni 1
Objekti

Objekti i kontrates eshte sigurimi vullnetar privat me qellim perfitimin e pensioneve suplementare.

Neni 2
Kushte te pergjithshme te kontrates

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, i Siguruari sigurohet ne skemen e pensioneve suplementare private, duke paguar kontributin mujor ne shumen e caktuar ne nenin 3, gjate periudhes se sigurimit te percaktuar ne nenin 4, ndersa Siguruesi garanton mbrojtjen dhe investimin e sigurte te fondit dhe ne perfundim te periudhes se sigurimit, t'i ktheje te Siguararit ne formen e pensionit suplementar kontributet e paguara prej tij te shtuara me interesin e perfituar nga manaxhimi i fondeve.

Neni 3

Masa dhe menyra e pageses se Kontributit nga i Siguruari

- 3.1 I Siguruari do te paguaje kontributin mujor ne masen(me poshte "Kontributi"), si rregull brenda dates 15 te çdo muaji si parapagim per muajt ne vazhdim. Nese kjo kontrate lidhet pas dates 15 te muajit, atehere i Siguruari do t'i paguaje Siguruesit kontributin e pare ne momentin e nenshkrimin te kontrates.
- 3.2 I siguruari mund te derdhe kontribute edhe per muajt perpara lidhjes se kontrates ne masen ----- leke ne muaj per nje periudhe ----- muaj.
- 3.3 Kontributët mujore suplementare derdhen nga i siguruari , ne llogarine bankare te çelur ne Banken qe Siguruesi do t'i beje te ditur.
- 3.4 Interesi do te llogaritet nga momenti i derdhjes se kontributeve.
- 3.5 I siguruari mund te kontribuojë ne çdo kohe me shuma te menjehershme, te cilat behen pjese e llogarise se tij individuale.
- 3.6 Kushtet e shtyrjes dhe/ose nderprerjes se pageses se Kontributit nga ana e te Siguararit parashikohen ne Rregulloren e Pensioneve te Siguruesit.

Neni 4
Periudha e Sigurimit

I Siguruari do t'i paguaje Siguruesit kontributin sipas nenit 3 me siper gjate gjithë periudhes se sigurimit. Kohezgjatja e periudhes se sigurimit eshte dhe do te llogaritet duke filluar nga muaji pasardhes i nenshkrimin te kesaj kontrate.

Neni 5
Transferimi i Kontributeve

- 5.1 I Siguruari ka te drejte te kerkoje nga Siguruesi qe te transferoje ne nje institut tjeter privat pensionesh kontributet qe ka derdhur prane Siguruesit, ne keto kushte ;
 - a) Pas nje viti nga krijimi i institutit ku eshte siguruar
 - b) Pas 3 vjet pagese kontributesh ne Institut
- 5.2 I Siguruari, nese ka plotesuar kushtet per te perfituar pensionin suplementar sipas kesaj kontrate, nuk ka te drejte te transferoje Kontributet nga Siguruesi tek nje institut tjeter privat pensionesh.



- 5.3 Siguruesi është i detyruar të kryejë transferimin e kontributeve së bashku me pjesën e fitimit të të siguruarit, në Institutin tjetër të pensioneve private të treguar në kërkesën me shkrim të të Siguarit, pas 6 (gjashtë) muajve nga data kur Siguruesi ka marrë kërkesën e të Siguarit. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet nga marrëveshja me institutin tjetër të pensioneve.

Neni 6 Pensionet

- 6.1 Pensionet suplementare që sigurohen nga Siguruesi, janë :
- a) **Pension Pleqërie**, ku kusht për të perfutur është arritja e moshës 40 vjeç për gratë dhe 45 vjeç për burrat si dhe plotësimi i periudhës së sigurimit minimalisht 5 vjet.
Pensioni i pleqërisë mund të jetë :
- Pension pleqërie me kohë të përcaktuar
 - Pension pleqërie i përhershëm
- b) **Pension vjetërsie në punë**, ku kusht për të perfutur është vetëm plotësimi i periudhës së sigurimit minimalisht 15 vjet
- 6.2 Palet bien dakord që i siguruarit të zgjedhë llojin e pensionit, në momentin që plotëson kushtet e perfutimit sipas ligjit nr. 7943, datë 1.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve".

Neni 7 Llogaritja e pensionit

- 7.1 Masa e pensionit suplementar llogaritet mbi bazën e kontributeve të paguara, të shtuara me interesin e perfutur nga manaxhimi i fondeve.
- 7.2 Siguruesi garanton investimin e fondeve të mbledhura në llogarinë e të Siguarit me rendimente maksimale brenda normave të lejuara të riskut të përcaktuara në nenin 38 të Ligjit nr. 7943, datë 1.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve" duke synuar interesin mesatar vjetor të Bonove të Thesarit të emetuara nga Qeveria e R.Sh.
- 7.3 Siguruesi, në përputhje me nenin 39 të Ligjit nr. 7943, datë 1.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", për administrimin e pensioneve suplementare do të mbajë si komision një përqindje të ulët të interesit të perfutur .

Neni 8 Perfitime të tjera

- Siguruesi, kur përmbushen kushtet e parashikuara në ligj dhe rregullore, ofron edhe perfitimet e mëposhtme :
- a) **Perfitime të pagueshme në formën e shumave të menjehershme**, c'ka do të thotë kur i siguruarit përmbush kushtet për pension mund të terheqë të gjithë ose një pjesë të llogarisë së tij në formën e një shume të menjehershme.
- b) **Shlyerje**. Ky lloj perfitimi i sigurohet të siguruarit që nuk ka përmbushur kushtet për pension por ka paguar kontribute të pakten 12 muaj kalendarike. Shlyerja do të llogaritet si shume e kontributeve të paguara nga i siguruarit me përqindjen e interesit nga manaxhimi i fondit.

Neni 9 Terheqja e perfitimeve

- 9.1 Pensioni suplementar/perfitimet e tjera, paguhen në filialet e bankës së nivelit të dytë, sipas marrëveshjes së lidhur për këtë qëllim nga siguruesi.
- 9.2 I Siguruarit deklaron se në rast vdekjeje të tij, të gjithë perfitimet sipas kësaj kontrate do t'i kalojnë , shtetas shqiptar, lindur më , në , mbajtes i pasaportes (bashkelidhur fotokopje e pasaportes) banues në adresën: Në rast të kundërt perfitimet i paguhen trashëgimtareve sipas dispozitave të Kodit Civil mbi trashëgiminë.

Neni 10 Kohezgjatja e kontratës

Në përputhje me vullnetin e të dyja paleve kontrata mund të rishihet çdo vit.

Neni 11 Kushtet e perfundimit të kontratës

Zgjidhja e kontratës mund të behet përjashtimisht përpara afatit edhe në këto raste, por sipas këtyre kushteve :

- 11.1 Në mënyrë të menjehershme nga i Siguruarit. Në këtë rast të siguruarit i kthehen vetëm kontributet e paguara prej tij të siguruesit. Shumat e paguara prej tij si kontribut mujor suplementar i kthehen brenda 1 muaji nga Siguruesi.
- 11.2 Pas një njoftimi paraprak me shkrim 3 muaj përpara nga i Siguruarit. Në këtë rast atij i kthehen kontributet që ka paguar në këtë skemë, së bashku me fitimin nga investimet e kontributeve, që gjenden në momentin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, brenda 1 muaji nga Siguruesi.



INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE
PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE

AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA

INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE

Neni 12
Te ndryshme

- 12.1 Per sa nuk parashikohet ne kete Kontrate, do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne Rregulloren e Siguruesit "Per perfitimet suplementare te te siguruarve....." dhe legjislacioni shqiptar per sa nuk parashikohet ne Rregulloren ne fjale. Çdo mosmarreveshje qe mund te lindi midis paleve te kesaj kontrate dhe qe nuk zgjidhet me mirekuptim mes tyre, do te zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane vendimi i te ciles eshte i ankimueshem sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.
- 12.2 Ndryshimi i kushteve te kesaj kontrate mund te behet vetem me shkrim dhe te nenshkruhet nga te dyja palet, ne te kundert eshte i pavlefshem.
- 12.3 Cdo njoftim, kerkese apo cdo lloj komunikimi ndermjet paleve do te behet me shkrim ne adresen e Siguruesit : **Rruga Mustafa Matohiti, Pal. 11/k, Kati 2, Zyra nr.1, Tirane.**
- 12.4 I Siguruari deklaron se ka patur ne dispozicion te gjithë kohen e nevojshme per t'u njohur me kete kontrate dhe te gjitha dispozitat e Rregullores se Pensioneve te Siguruesit dhe, pasi eshte njohur dhe i pranon keto dispozita, nenshkruan me vullnetin e tij te lire kete kontrate.
- 12.5. Kontrata hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj nga palet.
- 12.6 Kjo Kontrate hartohet ne 2 kopje ne gjuhen shqipe, me te njejten vlere secila.

SIGURUESI
INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE
SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE

Perfaqesuar nga

Arian KRAJA

Drejtor i Pergjithshem

I SIGURUARI

